

**ÇFARË  
ËSHTË  
QYTETARIA  
VEPRUESE**





# HYRJE

Mund të thuhet se tek ne janë hedhur hapat e parë në krijimin parakushteve për nxitjen e qytetarisë vepruese. Viteve të fundit, në kuadër të procesit të reformave, janë aprovuar një sërë ligjesh që mundësojnë dhe nxisin qytetarinë vepruese e cila ka rol të pazëvendësueshëm në zhvillimin e demokracisë dhe të shoqërisë civile.

Në Mal të Zi, megjithëse me vonesë, u paraqitën disa shembuj të suksesshëm të qytetarisë vepruese (siç ishte rasti i lumit Tara). Megjithatë vërehet një mungesë e theksuar e literaturës dhe shkëmbimit të përvojave nga regjioni e të cilat do të ofronin njohuri të reja inkurajuese.

Me këtë publikim kemi për qëllim që sadopak të plotësojmë këtë boshllëk dhe ndoshta të nxisim të tjerët që të merren më seriozisht me këtë segment të shoqërisë civile.

Qëllimi kryesor i kësaj broshure është fuqizimi i qëndrimeve dhe iniciativave të qytetarëve duke ofruar një kornizë konceptuale për njohjen e situatave konkrete.

Mesazhi kryesor i këtij teksti është: **vetëm kur qytetarë veprojnë bashkërisht dhe marrin pjesë në “politikën” ditore - paraqesin forcë të madhe në shoqërinë civile.**

Duke fuqizuar qytetarët si pjesëmarrës në jetën publike kontribuohet në zhvillimin e shoqërisë si dhe aftësimin e tyre për identifikimin dhe adresimin e problemeve me rëndësi publike.

Për këtë arsye, pushteti dhe shoqëria civile duhet të inkurajojnë qytetarët që të marrin mbi vete përgjegjësinë për kujdesin ndaj të mirave të përbashkëta, sepse pjesëmarrja qytetare ndihmon procesin e qeverisjes së mirë

Kjo broshurë u dedikohet **QYTETARËVE** e sidomos:

- atyre që janë të përfshirë në OJQ, asociacione apo lëvizje të ndryshme dhe dëshirojnë të përfitojnë njohuri dhe shkathtësi qytetare
- atyre që tregojnë interesim për pjesëmarrje në iniciativa qytetare dhe dëshirojnë të informohen „si”

Gjithashtu do t'u shërbej edhe atyre që kontaktojnë qytetarët në kryerjen e punëve publike (psh. politikanëve, nëpunësve publik, gazetarëve, afaristëve, ...) e të cilët besojnë se qytetarët janë faktor i rëndësishëm e jo pengesë në zgjidhjen e problemeve me interes të përbashkët.

Ky tekst është veçanërisht i rëndësishëm për funksionarët dhe nëpunësit e administratës lokale, pasi që me procesin e decentralizimit krijohet hapësirë e re për pjesëmarrjen qytetare. Duhet të dimë se qytetaria vepruese kryesisht është rezultat i veprimtimit ndaj problemeve që kanë karakter lokal.

Konsiderojmë se përdorimi i kësaj broshure do të ndihmojë në ngritjen e kapaciteteve të organizatave lokale qytetare dhe të subjekteve tjera, të cilat përmes punës së vet do të pasurojnë njohuritë nga ky tekst.

Botues:

**OJQ „HORIZONTI I RI“**

rr. Ymer Prizreni pn, Ulqin

Tel. 085/401-080, Fax. 085/411-969

e-mail: horizon@cg.yu

Përgatitën:

Nazif Veliqi

Xhemal Peroviq

Përgatitja teknike:

EXPEDITIO, Kotor

Shtypi:


Biro Konto, Herceg Novi

Donator:

Rockefeller Brothers Fund



Rockefeller  
Brothers Fund





<b>TË JESH QYTETAR, ÇFARË DO TË THOTË NË REALITET</b>	<b>6</b>
<b>Ç'ËSHTË QYTETARIA VEPRUESE</b>	<b>9</b>
<b>SI TA NJOHIM ANGAZHIMIN QYTETAR?</b>	<b>11</b>
<b>QYTETARIA VEPRUESE DHE QEVERISJA LOKALE</b>	<b>13</b>
<b>QYTETARIA VEPRUESE DHE POLITIKA</b>	<b>15</b>
<b>AMBIENTI I QYTETARISË VEPRUESE</b>	<b>19</b>

**QYTETARIA**  
**VEPRUESE**



# TË JESH QYTETAR, ÇFARË DO TË THOTË NË REALITET

Sipas mençurisë popullore, të jesh qytetar do të thotë t'i përkasësh bashkësisë dhe të kesh një sasi të caktuar të drejtash dhe detyrimesh ndaj institucioneve publike (bie fjala, detyrimi i pagimit të tatimit dhe e drejta e sigurisë).

Mirëpo, kur e shikojmë jetën e përditshme, ku njerëzit duhet të përballen me problemet që tek ata ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, në kuptimin bashkëkohor të jesh qytetar do të thotë mbrojtje të qëndrimeve të veta dhe realizim të të drejtave konkrete.

Një ngjarje nga Italia, që ka të bëjë me mbrojtjen shëndetësore, e ilustron më së miri një veprim të qytetarit aktiv.

## **Rasti i z. Fabricio**

*Z. Fabricio, një sipërmarrës rreth moshës 60 vjeçare, para shumë vitesh u nis nga rajoni jugor i Italisë për t'u shtruar në një spital në Romë. Ai ishte sëmurë nga zemra dhe duhej të operohej.*

*Pasi arriti në spital, u pranua në repartin e kirurgjisë kardiovaskulare, ku gjeti rreth njëzet pacientë të tjerë që prisnin të njëjtin operacion. Prania e një numri kaq të madh njerëzish e hutoi z. Fabricio, kështu që gjurmoi rreth e rrotull dhe u informua se spitalit i mungonin paratë për blerjen e pejsmejkerëve. Pasi që nuk kishte mjete, duhej që të prisnin të gjithë (askush nuk e dinte se për sa kohë) që spitali t'i blejë pejsmejkerët, e pastaj t'i operojnë të sëmurët. Z. Fabricio gjithsesi nuk ishte "më i sëmuri" nga pacientët dhe gjithashtu ishte i pakënaqur që ishte mbyllur në një dhomë të vogël, i veshur me pizhamet e veta dhe që i duhej të duronte në pritjen e terminëve absurde. Por, durimi vërtetë iu sos kur fluturimthi bëri disa përlogaritje dhe kur e kuptoi se me paratë që spitali i shpenzonte për qëndrimin e njëzet pacientëve pa kurrfarë arsyeje, mund të blihen lehtë më shumë pejsmejkerë seç ishte e nevojshme dhe se këto para madje janë të mjaftueshme që spitali të pajiset me ta deri në fund të vitit. Kështu z. Fabricio vendosi të fillojë grevën e urisë në spital. Ai e njoftoi zyrtarisht kryeinfermieren lidhur me vendimin e vet dhe i ftoi gazetata lokale dhe Tribunalin për të drejtat e pacientëve. Natyrisht, kur lajmi për grevën e tij mori dheun, drejtuesit e spitali i zuri paniku, sidomos për shkak se për këtë ish-in njoftuar kryetari dhe ministri rajonal i shëndetësisë. Aq më tepër, nuk ndodhë çdo ditë që i sëmuri nga zemra, i cili në spital pret operacionin, të fillojë grevën e urisë.*

*Të gjitha tentativat që z. Fabricio të heqë dorë nga greva, si nga drejtori i spitalit ashtu edhe nga kryemjeku në repart ishin të kota. Z. Fabricio ishte*

këmbëngulës. Madje as tentativat për ta frikësuar, duke i thënë se çfarë dëmi mund t'i shkaktojë kjo shëndetit të tij, nuk arritën asgjë tjetër veçse shtuan këmbëngulësinë dhe vendosmërinë e tij. Ai u thoshte: "Nëse më ndodhë ndonjë gjë, ju do të jeni fajtorë". Bile bile, ka pasur edhe tentativa, ndonëse mjaft naive, për ta rryshfetu.

Askush s'e din se në ç'mënyrë, por personeli mjekësor arriti të gjejë pejsmejkerin. Nxituan deri tek ai, të gatshëm për t'i bërë menjëherë operacion. Por, z. Fabricio thoshte se një gjë e tillë nuk vjen në konsiderim dhe se në operacion do të shkojë i fundit, sepse para tij duhet t'i operojnë të gjithë pacientët e tjerë.

Më në fund, askush s'e din se në ç'mënyrë, por mjetet u siguruan, pejsmejkerët u blenë dhe pacientët u operuan. Pra, të gjithë përfituan: pacientët, të cilëve iu mbrojti e drejta për shëndet të mirë dhe shteti, i cili i dha fund shpenzimit të kotë dhe absurd të mjeteve financiare.

Pas operacionit të suksesshëm z. Fabricio u përshëndet me të gjithë dhe u kthye në shtëpi.

Përmes veprimit siç ishte ky, njerëzit realizojnë qytetarinë (të drejtën qytetare) sipas mënyrave që dallojnë plotësisht nga qytetaria tradicionale.

**Qytetaria tradicionale mund të përkufizohet si sistem i të drejtave dhe detyrimeve të ndryshme me të cilat rregullohet raporti midis qytetarit dhe shtetit të cilit i takon. Realizimi i së drejtës së votimit është forma më e rëndësishme e shprehjes së qytetarisë.**

Edhe pse nocioni tradicional i qytetarisë ka rëndësi kyçe, ai përmban në vete dy kufizime të mëdha.

---> **Kufizimi i parë – nënçmon potencialin e individëve**, të cilët konsiderohen vetëm si votues, e të cilët megjithatë nuk mund të qeverisin punët publike.

---> **Kufizimi i dytë – nënkupton aftësinë e institucioneve publike** që t'i qeverisin vetë punët publike, t'i zgjidhin nevojat e njerëzve dhe t'i mbrojnë të drejtat e qytetarëve.

Të dyja supozimet janë të gabuara:

- Anëmbanë botës njerëzit mund të bëjnë më shumë se akti i votimit, për t'u kujdesur për interesin publik;
- Institucionet publike nuk janë të afta që **vetëm** t'i zgjidhin problemet që paraqesin interes publik.

**Qytetarinë e re mund ta përkufizojmë si realizim i autorizimeve dhe përgjegjësi të qytetarëve në jetën e përditshme të demokracisë, ku ballafaqohemi me probleme të rëndësishme publike.**

**Në ç'mënyrë dhe pse një individ mund të jetë i motivuar që të jetë qytetar veprues?**

Mund të ketë disa arsye:

- Dëshira për drejtësi
- Ndjenja e solidaritetit
- Dëshira për ta ndryshuar gjendjen ekzistuese
- Dëshira që të "pyetet" dhe të luajë rolin prijatar
- Dëshira për t'iu bashkuar të tjerëve dhe për të zhvilluar marrëdhënie bashkëpunimi dhe marrëdhënie miqësore dhe
- Dëshira për ta perceptuar realitetin " nga dora e parë", pa ndërmjetës.


Tekefundit, individi gjatë jetës së vet mund të bëhet qytetar veprues si rrjedhim i një numri të madh të shkaqeve, vlerave dhe rrethanave. Të jesh qytetar veprues nuk i përjashton grupet e caktuara, siç janë sipërmarrësit, tregtarët apo specialistët. Çdokush mund të jetë qytetar veprues nëse angazhohet dhe përfaqëson interesin publik (por jo për interes personal).



---> **Mjeku në spital**, i cili kërkon ushqim më cilësor për pacientët, kërkon lista transparente të pritjes apo i kundërvihet korrupsionit, burokracisë dhe paternalizmit, është qytetar veprues.

---> **Sipërmarrësi**, i cili mbështet financiarisht dhe teknikisht rregullimin e parkut publik në rajonin ku punon fabrika e tij, është qytetar veprues.

---> **Nëpunësi shtetëror**, i cili jashtë orarit të rregullt i këshillon qytetarët me nevoja të veçanta lidhur me procedurat administrative, është qytetar veprues.





# Ç'ËSHTË QYTETARIA VEPRUESE

## Qytetaria

Është me rëndësi të shqyrtohen mundësitë e qytetarëve të thjeshtë (të cilët ende nuk janë organizuar) që të bëhen avancues të shoqërisë civile. Çdokush ka mundësi të bëhet i ndërgjegjshëm për ndonjë problem, vendim, të drejtë dhe ligj, që kanë ndikim në jetën e tij dhe çdokush ka një dozë talenti dhe shkathtësie të nevojshme për t'u bërë qytetar veprues. Ekzistojnë mundësi të panumërta për avancimin dhe zhvillimin e këtyre shkathtësive, sidomos ndër grupet e marginalizuara dhe të goditura të shoqërisë, ku padrejtësia që u është bërë degradon jetën e tyre. **Të aftësuarit e qytetarëve që të angazhohen, duke i bërë përgjegjës udhëheqësit e tyre dhe puna e bërë për ndryshimet e qeta sociale janë udhërrëfyes për ndërtimin e shoqërisë së qëndrueshme civile.**

Avancimi i marrëdhënieve ndërnjerëzore është i rëndësishëm për shoqërinë civile. Këto marrëdhënie do të tregojnë se sa fuqimisht bashkëpunojnë pjesëmarrësit në realizimin e ndryshimeve të rëndësishme. Gjithashtu do të determinojnë mënyrën me të cilën pjesëmarrësit mund të bëjnë garë të qetë me njëri tjetrin për qëllimet e veta individuale. Është vështirë të zhvillohen marrëdhëniet ndërnjerëzore, sidomos në një mjedis me shumë grupe që kanë interesa të ndryshme. Për këtë arsye është qenësore të bashkohen pjesëmarrësit dhe t'u ndihmohet në ndërtimin e urave për marrëdhënie të mira e të qëndrueshme ndërnjerëzore.

Përveç përvojave dhe motivimeve të çdo individi për t'u bërë qytetar veprues, si mund të vështrohet ky fenomen në një mënyrë më objektive? Qytetari veprues e dëshmon plotësisht vetveten kur bashkohet me të tjerët me qëllim të arritjes së qëllimit të përbashkët.

Qytetaria aktive mund të realizohet nëpërmjet formave të llojllojshme, siç janë:

- **Organizatave vullnetare**
- **Grupet e njerëzve të thjeshtë dhe bashkësitë**
- **Shoqatat**
- **Grupet për vetëmbrojtje**
- **Lëvizjet për përfaqësim, si bie fjala, të mjedisit jetësor**
- **Rrjetet dhe koalicionet**

Këto organizata mund të ndërhyjnë në fusha të ndryshme. Shembujt e qytetarisë vepruese mund të përfshijnë:

- Dhënien e shërbimeve dhe përfaqësimin e pakicave
- Promovimin e përkujdesjes dhe të birësimit të fëmijëve të braktisur
- Ndalimin e ndërtimit të pamasë dhe luftën kundër ndërtimit të palejuar
- Hartimin e programeve të mësimi plotësues për fëmijët për të cilët ekziston droja se do ta braktisin shkollën

- Dhënie e ndihmës juridike, psikologjike dhe materiale personave të rrezikuar
- Krijimin e mundësive të barabarta për njerëzit që ndodhen në pozitë të pavolitshme
- Luftën kundër korrupsionit në jetën publike
- Luftën për sigurimin e barnave për të sëmurët kronikë
- Kontrollin dhe përmirësimin e cilësisë së spitaleve, shkollave, çerdheve....

### Si mund të përkufizohen këto aksione dhe iniciativa?


Në Doracakun e tij për qytetarinë vepruese, Gjovani Moro jep këtë përkufizim: ***Qytetaria vepruese është kapacitet i qytetarëve që të vetorganizohen pavarësisht në mënyra të ndryshme për t'i mbrojtur të drejtat e veta, për t'i realizuar autorizimet dhe për t'i përmbushur detyrimet në rregullimin shoqëror me qëllim të përkujdesjes për të mirën publike.***

Njeriu mund të bëhet qytetar veprues për shkaqe të ndryshme. Qytetaria vepruese përfshin tubimin, vetorganizimin dhe shfrytëzimin e formave të veprimit të përbashkët. Siç thotë një këngë e vjetër sindikale, një gurë nuk bën qemerin, kurse vetëm një pikë uji nuk mund ta lëvizë gurin e mullirit. Është me rëndësi të rikujtojmë këtë përmasë kolektive të nocionit në kohën kur shpeshherë thuhet se një lider politik ka zgjidhje për secilin problem. Fusha e veprimit të qytetarisë vepruese është sajimi i politikave publike. Qëllim i politikave publike është që të merren me problemet që paraqesin interes publik, siç janë shëndetësia, arsimi, komunikacioni apo punësimi. Ato paraqesin dimensionin e përditshëm dhe praktik të demokracisë, në të cilën qytetaria vepruese duhet të luajë rolin kryesor.

Qytetaria vepruese përfshin disa organizata të caktuara. Me fjalë të tjera, nuk janë të gjitha shoqatat e qytetarëve organizata të "qytetarisë vepruese". Bie fjala, shoqatat sportive, klubet e shahut, rrjetet e motoçiklistëve, grupet e miqve të poezisë, orkestrat amatore dhe shoqëritë kulturore – artistike janë shoqata të individëve që janë qytetarë, por nuk konsiderohen organizata të "qytetarisë vepruese".

Qytetaria vepruese dhe shoqëria qytetare (civile) janë nocione të ndryshme, ndonëse të ndërlidhura.

Shoqëria qytetare ka të bëjë me sferën ku subjektet joshitetore kanë të njëjtat vlera dhe rregulla. Ajo përfshin subjekte të ndryshme, siç janë organizatat fetare, shoqatat profesionale, shkollat dhe universitetet, sindikatat, qendrat sportive, muzikore, artistike, rekreative, etj. Organizatat e qytetarisë vepruese janë pjesë e kësaj sfere, mirëpo qëllimi i tyre është mbrojtja e të drejtave dhe përkujdesja për interesin e përgjithshëm përmes realizimit të autorizimeve dhe përmbushjes së detyrimeve të qytetarëve. Cilat janë lidhjet midis organizatave të qytetarisë vepruese dhe shoqatave të tjera të qytetarëve dhe forcave të shoqërisë civile?



Të gjitha subjektet bashkëpunojnë në krijimin dhe rritjen e “vlerës shoqërore”, që do të thotë rritjen e ndërlidhjeve që bazohet në vlera, reciprocitet dhe mirëbesim e që paraqesin thelbin e shoqërisë. Mirëpo, organizatat e qytetarëve vepruese janë përkushtuar qëllimit për fuqizimin e qytetarëve si subjekte që duhet të luajnë rol aktiv në mbrojtjen e të drejtave të veta.

## SI TA NJOHIM ANGAZHIMIN QYTETAR?

Demokrati do të thotë shumë më tepër sesa zgjedhjet e lira dhe pushteti, ndonëse ato janë pikënisja e saj.

Pushteti në shoqërinë demokratike duhet të bëhet dhe të mbetet partner midis qytetarëve dhe funksionarëve të zgjedhur të cilëve qytetarët ua kanë dhënë besimin e tyre.

Ky besim duhet të zgjerohet ndaj nëpunësve publikë dhe institucioneve të pushtetit.

Në vendet demokratike, ky besim është arritur përmes:

---> Transparencës së punës të nëpunësve të zgjedhur;

---> Mundësisë së dhënë qytetarëve që të luajnë rol të rëndësishëm në pushtet, madje edhe në aktivitetet e përditshme.



Angazhimi qytetar në marrjen e vendimeve është proces gradual, i cili nënkupton disa faza që duhen kaluar. Këto faza janë pjesë e pandarë e dy niveleve të angazhimit qytetar:

**1. Niveli i parë i pjesëmarrjes është informimi**, që do të thotë se duhet të bëhen përpjekje si nga ana e qytetarëve, ashtu edhe nga ana e pushtetit. Pushteti publik ka për detyrë t’u japë informacione qytetarëve në lidhje me aktivitetet dhe planet e tyre, në mënyrë që qytetarët t’i kuptojnë drejtimit prioritar në ushtrimin e politikave dhe në veprimin e funksionarëve të zgjedhur;

**2. Niveli i dytë ka të bëjë me konsultimet e qytetarëve,** që paraqet aktivitetin e pushtetit që të identifikojë nevojat e qytetarëve, të përcaktojë përparësitë apo të mbledhë idetë dhe sugjerimet për çështje të caktuara.

### Angazhimi i mirëfilltë i qytetarëve nënkupton:

- Qytetarët veprues dhe të informuar, të cilët e dinë se kanë për detyrë të marrin pjesë në aktivitetet e pushtetit si partnerë të barabartë, sepse e kuptojnë problematikën.
- Mënyrën efektive të grumbullimit të informacioneve të qytetarëve lidhur me nevojat, mendimet dhe prioritetet e tyre.
- Interesimin e qytetarëve për përfshirje në të gjitha aktivitetet që i ndërmerr pushteti.
- Përcjelljen konstante të informacioneve nga qytetarët kah pushteti.

Angazhimi qytetar është kombinim - i informacioneve, komunikimit dhe i përfshirjes në raportet e vendosura ndërmjet pushtetit dhe qytetarëve. Aktivitetet e pushtetit janë të zhvilluara dhe të qëndrueshme përderisa i ndjekin nevojat dhe dëshirat e qytetarëve, sa më tepër që të jetë e mundshme.

### Cilat janë mënyrat e tjera të angazhimit të qytetarëve?

- Informimi përmes mediave mbi problemet dhe përfaqësuesit e zgjedhur
- Të shkruarit në media mbi problemet dhe përfaqësuesit e zgjedhur
- Debatimi mbi problemet në rrethana formale dhe joformale
- Puna në bashkësi për të mirën e përgjithshme apo protestimi kundër vendimeve të qeverisë, ndoshta duke u angazhuar vullnetarisht në OJQ-të, në dobishmërinë e të cilave beson.
- Themelimi apo bashkimi:
  - me grupet aktive në komunitetin lokal
  - me grupet për të rinjtë
  - me organizatat profesionale
  - me grupet feministe
  - me grupet e biznesit
  - me partitë politike
  - me organizatat fetare.
- Pjesëmarrja në mbledhjet e komunitetit apo në mbledhjet politike
- Votimi në zgjedhje
- Fushatat për ata që bëjnë garë për funksion
- Pagimi i tatimit
- Grumbullimi i përkrahjeve për çështjet që paraqesin interes të përgjithshëm, ndoshta përmes petitionit
- Shfrytëzimi i rrugëve legale në kërkimin e drejtësisë
- Angazhimi në protesta paqësore siç janë demonstratat, grevat dhe bojkotet.



# QYTETARIA VEPRUESE DHE QEVERISJA LOKALE

Mund të thuhet se funksionet e organizatave qytetare që janë theksuar në tekstin paraprak janë detyra të qeverisjes lokale. Sipas këtij vizioni, kryetari i komunës apo qeverisja lokale, e jo qytetarët, duhet t'i mbrojnë të drejtat e tyre dhe të kujdesen për të mirën e përgjithshme. Nga kjo perspektivë, nga qytetarët pritet që t'ia shfaqin nevojat dhe kërkesat e veta qeverisjes lokale, e cila është e detyruar të japë përgjigjet përkatëse.

Mirëpo, qeverisja lokale shpeshherë nuk ka autorizime, informacione apo resurse adekuate për t'i përmbushur nevojat e njerëzve. Megjithatë, në shumicën e rasteve në praktikë, administratat janë pikërisht ato që nuk i respektojnë të drejtat e qytetarëve.

Në përputhje me këtë, në mënyrë që t'u plotësohen dëshirat dhe të zgjidhen kërkesat e tyre legjitime, **qytetarët nuk mund të kufizohen vetëm në parashtrimin e pyetjeve por duhet të kontribuojnë edhe në gjetjen e zgjidhjeve.**

Në nivel të pushtetit lokal, ideja e pjesëmarrjes së qytetarëve në pushtet ka domethënienë të thellë. Kjo ndodhë për shkak se njerëzit jetojnë në qytete, vendbanime (qyteza, qendra e banuar, lagjja, fshati, etj) dhe pikërisht këtu:

---> **vendimet e pushtetit ushtrojnë ndikimin më të madh mbi njerëzit, kurse**  
---> **pjesëmarrja e qytetarëve arrihet më së lehti.**

Natyrisht, qytetarët gjithashtu do të duhej t'i kuptonin përgjegjësitë e veta në procesin e pushtetit demokratik. Në komunitetin lokal, ku qytetarët dhe pushteti janë të përfshirë në mënyrë aktive në procesin e angazhimit qytetar, pushteti lokal do të jetë i gatshëm që:

- të japë informacione të sinqerta, të gjithanshme dhe të qarta;
- t'u mundësojë qytetarëve që t'i shfaqin mendimet e veta dhe të ndikojnë në mënyrë të ndershme dhe të hapët në vendimmarrje;
- t'i inkurajojë qytetarët që t'i shfrytëzojnë këto mundësi;
- të angazhohet dhe të sqarojë mënyrën e marrjes së vendimeve duke paraqitur të gjitha argumentet që i arsyetojnë këto vendime.

## **Në të njëjtën kohë, qytetarët:**

- do t'i kuptojnë të drejtat dhe detyrimet që u janë parashtruar për të marrë pjesë në vendimmarrje në nivel lokale, sepse këto vendime mund të ndikojnë drejtpërsëdrejti apo tërthorazi në jetën e tyre;
- do të jenë të gatshëm të punojnë në mënyrë të sinqertë dhe konstruktive për t'i mbështetur përfaqësuesit e pushtetit lokal në zgjidhjen e çështjeve të hapura.



Nevoja e bashkëpunimit midis qytetarëve dhe organeve të pushtetit nënkupton një trajtim të ri të **“qeverisjes”**.

**Nga aspekti i trajtimit përfshirës të qeverisjes, duhet pranuar se administratat lokale nuk mund t’i zgjidhin më vetëm (pa pjesëmarrjen e të tjerëve) problemet me të cilat ballafaqohen. Këto çështje mund t’i zgjidhin vetëm duke i ftuar të gjitha subjektet publike, private dhe shoqërore (përfshirë edhe qytetarët) që janë angazhuar në problem për të marrë mbi vete një pjesë të përgjegjësisë. Për ta qeverisur bashkësinë, na nevojitet “bashkëqeverisja”, në kuadër të së cilës qytetarët nuk janë më vetëm shfrytëzues të politikës publike, por pjesërisht janë përgjegjës edhe për planifikimin e politikës, për zbatimin e saj dhe për dhënien e vlerësimeve.**

Brenda kësaj kornize qeverisëse, qytetarët veprues mund të kontribuojnë në mënyrë konstruktive në dialogun me qeverisjen lokale. Raporti midis qytetarit dhe qeverisjes lokale ka rëndësi të veçantë.

Jo vetëm për shkak se organet e qeverisjes lokale janë më të afërta me qytetarët, por edhe për shkak se janë drejtpërsëdrejti dhe konkretisht përgjegjëse për zgjidhjen e atyre problemeve të cilat më së shumti i preokupojnë njerëzit.

Ky bashkëpunim mund të marrë forma të ndryshme, si:

- dhënia e informacioneve
- mbështetja e iniciativave qytetare
- projektet në partneritet
- lidhja e kontratave me organizatat e qytetarëve për zbatimin e programeve publike apo për dhënien e shërbimeve.

Çfarëdo forme që të ketë marrë ky bashkëpunim, me rëndësi të veçantë është që në raportet midis qytetarëve dhe administratës publike të mundësohet **autonomia** dhe **barazia**.



Trajtimi i ri i qeverisjes në realitet është sfidë për qeverisjen lokale. Trajtimi i këtillë vërtetë tejkalon parimin tradicional të lirisë së bashkimit, ku shteti duhet t'u garantojë qytetarëve mundësinë e bashkimit dhe të organizimit për qëllime private.

Vërtetë, ai mbështetet në vetorganizimin e qytetarëve për qëllimet e promovimit të interesit të përgjithshëm, që tradicionalisht konsiderohej si monopol ekskluziv i pushtetit.

## QYTETARIA VEPRUESE DHE POLITIKA

Temë jashtëzakonisht e nxehtë është raporti midis qytetarisë vepruese dhe politikës, përfshirë partitë, zgjedhjet apo kuvendet.

Qytetarët veprues shpeshherë ndihen vartës apo mendojnë se mundësitë dhe aftësitë e tyre janë më të vogla nga ato që i kanë aktorët e politikës zyrtare. Si pasojë e kësaj ndodhin sjellje të çuditshme, siç është tentativa për t'u bërë i afërt me këshilltarin apo funksionarin në pushtet dhe të fitojë besimin e tyre ose dalldisja pas idesë së daljes në garë zgjedhore si alternativë e partive politike ekzistuese. Gjithashtu, mund të ketë tentativa për t'iu shmangur çfarëdo kontakti me politikën si rezultat i frikës nga "përlyerja e duarve" apo i të menduarit "po ...ata edhe ashtu vendosin vet për çdo gjë".

### Çka mund të thuhet lidhur me këtë temë të ndërlikuar?

Qytetaria vepruese nënkupton edhe përvojë politike të caktuar, sepse ka të bëjë me qeverisjen e shoqërisë dhe me ndërhyrje në konfliktet që janë karakteristike e këtij procesi. Ndërkaq, kjo dallon plotësisht nga partitë dhe koalicionet që bëjnë garë në zgjedhje dhe të cilat përbëjnë kuvendet e zgjedhura.

#### Pse?

- > Sepse partitë merren me qeverisjen e shtetit, kurse qytetaria aktive kontribuon në qeverisjen e shoqërisë dhe mbetet pjesë e saj.
- > Sepse nuk ekziston përputhja midis organizatave të qytetarëve veprues dhe partive politike, madje edhe nëse organizatat e caktuara janë të ndërlidhura me partitë e caktuara.
- > Sepse konsensusi dhe mbështetja e fituar në cilësinë e qytetarit veprues nuk shndërrohen në vota, respektivisht në aftësinë që të ndikohet në elektorat. Çdokush që lajthitet për ta bërë këtë (për shembull, "partitë e konsumatorëve" / "grupet e shfrytëzuesve") faktet do t'i demantonin gjithmonë.

Duhet theksuar se për demokracinë funksionale janë të nevojshme edhe partitë edhe organizatat qytetare. Së këndejmi në realitet nuk është e vërtetë ajo që thonë shpeshherë politikanët se “organizatat qytetare ekzistojnë sepse gjërat nuk funksionojnë; për këtë arsye duhet të punojmë aq mirë, saqë të mos ketë më nevojë për këso organizatash”.

Gjithashtu është me rëndësi vendimtare që partitë politike dhe qytetarët veprues si dhe të gjitha subjektet e tjera të gjejnë mënyrën që të veprojnë bashkërisht dhe të bashkëpunojnë me njëri tjetrin pavarësisht nga dallimet e tyre dhe nga konfliktet e mundshme. Megjithatë, asnjë arsye nuk mund të shërbejë si pretekst për qytetarët veprues që të mos marrin mbi vete përgjegjësitë vetjake përkitazi me reformën dhe avancimin e demokracisë. Kjo reformë në realitet u përket qytetarëve, pavarësisht nëse ata janë zgjedhës apo “të zgjedhur” dhe prandaj nuk mund të konsiderohet se nuk bën pjesë në sferën e interesit të qytetarisë vepruese.


### Qytetari si shtyllë e shoqërisë civile

Duke marrë parasysh faktin se angazhimi qytetar për shumë njerëz është ide e re, si përfaqësuesit e pushtetit ashtu edhe qytetarët do të duhej të ishin iniciator të këtij procesi. Për këtë arsye është i nevojshëm një angazhim më i madh i liderëve lokalë për pjesëmarrje qytetare, duke filluar nga kryetari i komunës dhe bashkëpunëtorët e tij më të afërt. **Kryetari i komunës dhe bashkëpunëtorët e tij do të duhej që sa më shpesh dhe në mënyrë të qartë e të sinqertë ta shprehin publikisht angazhimin e vet për pjesëmarrjen qytetare.**

Në planifikimin e angazhimit qytetar, është e nevojshme që organet e pushtetit të mendojnë për qytetarët si për myshteri në punë. Ideja është që gjithnjë, përdërisa qytetarët t’i paguajnë taksat dhe kontributet do të duhej t’u mundësohet “për t’i blerë” ato shërbime që u nevojiten. Nëse pushteti financohet nga këto taksa dhe kontribute do të duhej të synojë që të sigurohet cilësia më e mirë dhe më e dobishme e shërbimeve.

Në pushtetin e orientuar drejt qytetarëve (klientëve), duhet të mbizotërojnë parimet e mëposhtme:

- Q**
- është individi më i rëndësishëm për nëpunësin civil.
- Y**
- nuk varet nga pushteti - pushteti varet nga ai.
- T**
- nuk pengon punën e pushtetit - ai është vetë qëllimi i punës dhe i ekzistimit të pushtetit.
- E**
- nuk është jashtë aktiviteteve të pushtetit - ai është pjesë e këtij aktiviteti.
- T**
- nuk është figurë statistike boshe - ai është qenie njerëzore me ndjenja dhe emocione, me paragjykime dhe preferenca.
- A**
- nuk është dikush kundër të cilit pushteti do të duhej të luftonte apo të provojë forcën me të. Askush nuk ka fituar kurrë duke u rrahur me klientin.
- R**
- i shfaq publikisht dëshirat e veta. Misioni i pushtetit është që këto dëshira t’i trajtojë në mënyrë të dobishme për të dyja palët.
- I**





## Qytetari ka edhe përgjegjësi

Angazhimi qytetar nuk është vetëm përgjegjësi e përfaqësuesve të pushtetit. Qytetarët gjithashtu kanë përgjegjësi.

### Detyrat e qytetarëve janë:

- Të kuptojnë se çka punon pushteti dhe çfarë qëllimi ka.
- Të jenë të gatshëm të japin kontributin e vet kur pushteti planifikon të bëjë diçka që do të mund të ndikonte në interesat e tyre.
- Të sillen ndaj përfaqësuesve të pushtetit me një qëndrim pozitiv.
- Të shfaqin interesim në kuptimin e problemit dhe të vlerësojnë në mënyrë objektive se çfarë mund të bëjë pushteti.
- Të shfaqin idetë dhe mendimet e veta në mënyrë të qartë dhe të plotë.

Pasi të kenë marrë votëbesimin e qytetarëve, nëpunësit përgjegjës të pushtetit kanë për detyrë të dëgjojnë atë që ua thonë qytetarët dhe t'i marrin në konsiderim idetë e tyre.

Ideja që vjen nga qytetarët mund të pranohet apo të refuzohet. Përfaqësuesit e pushtetit do të duhej të sqaronin arsyen pse ndonjë ide nuk mund të realizohet në praktikë. Në rastin kur përfaqësuesit e pushtetit nuk i informojnë qytetarët për shkaqet e mospranimit të ideve të tyre, qytetarët mund të kërkojnë dhe duhet të kërkojnë sqarim për vendimet e tilla. Sugjerimi, propozimi apo ankesa e paraqitur nga qytetarët mund të pranohet apo të refuzohet, por nuk do të duhej të injorohej.

### Çka sjell angazhimi i qytetarëve?

Në atë bashkësi ku angazhimi i qytetarëve në procesin e ushtrimit të pushtetit merret në mënyrë serioze, dobitë janë të mëdha si për pushtetin lokal ashtu edhe për qytetarët.





### Angazhimi i qytetarëve:

- Vendos dhe ndërton mirëbesimin midis pushtetit lokal dhe qytetarëve.
- I ndihmon pushtetit lokal që të bëhet dhe të mbetet transparent në procesin e ushtrimit të pushtetit.
- I lejon çdo qytetari shfrytëzimin e lirë të informacioneve lidhur me çështjet e caktuara.
- I mundëson pushtetit lokal që të identifikojë nevojat e bashkësisë në mënyrë më të shpejtë dhe me satisfaksion më të madh për qytetarët.
- Inkurajon debate sy më sy, ashtu që qytetarët mund të dëgjojnë drejtpërsë drejti qëndrime të ndryshme.
- E orienton bashkësinë drejt vendimeve të ndërgjegjshme dhe politikisht të përkrahshme.
- E çon bashkësinë drejt konsensusit, duke tejkaluar konfliktet.
- I ndihmon pushtetit lokal që të zgjidhë nevojat e qytetarëve para se të zgjidhë interesat e tyre të veçanta.

Ngandonjëherë, pushteti lokal detyrohet të ndajë edhe lajme të këqija me qytetarët, si bie fjala: deficitet e buxhetit, realizimin me vonesë të projekteve apo madje edhe gabimet që janë bërë. Qytetarët kanë të drejtë që të informohen për planet dhe projektet nga fillimi deri te realizimi i tyre. Në qoftë se projekti është i vështirë apo kushton më shumë seç është paraqitur, ata kanë të drejtë të dinë për këtë. Në planin afatgjatë, sinqeriteti ndërton mirëbesimin, ndonëse krijon vështirësi në planin afatshkurtër.

### Si të nxitet pjesëmarrja e qytetarëve?

Domethënia e idesë së pjesëmarrjes së qytetarëve është komunikimi i dyanshëm:


- nga pushteti drejt qytetarëve;
- nga qytetarët drejt pushtetit.

Komunikimi i dyanshëm do të thotë se qytetarët mund t'i zbulojnë përparësitë e mundësive që paraqiten, të mësojnë se çka po ndodhë në bashkësinë e tyre apo në pushtetin lokal dhe mendimet e veta t'i ndajnë me organet e pushtetit. Ata do të duhej që të kërkonin në mënyrë aktive format e komunikimit me organet e pushtetit. Kjo nuk është lehtë të bëhet në çdo situatë, madje as në demokracitë e zhvilluara.

**Fushatat publike, edukative dhe fushatat për ngritjen e vetëdijes mund të jenë të domosdoshme për t'u ndihmuar qytetarëve që të kuptojnë rëndësinë e përgjegjësisë së tyre që të veprojnë në mënyrë konstruktive ndaj përfaqësuesve të pushtetit.** Pushteti dhe OJQ-të mund ta drejtojnë dhe do të duhej ta drejtonin këtë proces, nëse një gjë e tillë kërkohet ose është e domosdoshme. Organizimi i dëgjësave publike apo i fokus grupeve me kategoritë e ndryshme të qytetarëve, janë disa nga mënyrat që mund të ndikojnë në përmirësimin e komunikimit midis pushtetit dhe qytetarëve.



# AMBIENTI I QYTETARISË VEPRUESE



Kultura mbizotëruese në Mal të Zi në kuptim të angazhimit qytetar para do kohe karakterizohej nga pasiviteti i qytetarëve, të cilët nuk reagonin kundër të metave apo kundër shërbimeve publike joadekuate; kundër keqpërdorimit të të drejtave kushtetuese apo ligjore dhe kundër pjesëmarrjes së kufizuar në hartimin dhe zbatimin e politikave publike. Organet shtetërore nuk janë konsultuar gjithherë me të gjitha palët e interesuara në shoqëri dhe as që i kanë angazhuar. Në raste të shumta OJQ-të lokale dhe bashkësia ndërkombëtare përmes programeve dhe projekteve të veta në Mal të Zi, i nxitën organet shtetërore që t'i kycin qytetarët në hartimin e politikave. Ndonëse shumica e qytetarëve në Mal të Zi i shikon ende funksionarët në pushtet si njerëz me influencë me të cilët është vështirë për t'u përballur, shumë qytetarë fillojnë ta kuptojnë se funksionarët shtetëror nuk janë pronarë të funksioneve të veta publike, por individë që paguhen nga të ardhurat publike për të punuar në shërbim të qytetarëve.

Si rezultat i kësaj dhe i angazhimit të mëtutjeshëm të OJQ-ve në aspektin edukativ, gjasat janë më të mëdha se qytetarët do të veprojnë kur të jenë rrezikuar drejtpërsëdrejti interesat e tyre.

Në raste të shumta qytetarët veprojnë kur ballafaqohen me çështjet dhe problemet që kanë të bëjnë me tërë komunitetin. Megjithatë, më të shpeshta janë rastet që kanë karakter lokal dhe që ndonjëherë i përkasin interesit publik të bashkësisë më të ngushtë. Sa për ilustrim, po cekim disa shembuj të aktivizmit qytetar në territorin e Komunës së Ulqinit viteve të fundit: *Iniciativa e grupit të qytetarëve me rastin e shitjes së hoteleve të Ulqinit - rreth 2000 nënshkrime të grumbulluara nuk dhanë rezultat; Iniciativa për përvijimin e zonës së të mirave detare në përputhje me Ligjin; Iniciativa /protesta/ për kthimin e Ullishtës; Iniciativa e OJQ-ve lokale për lirin e trotuareve . . .*

Në një numër të caktuar të rasteve, mediat luajnë rol aktiv në shfaqjen e shqetësimit lidhur me problemet e ndryshme të bashkësive. Mediat kanë qenë ato që kanë shfaqur publikisht problemet me të cilat përballen bashkësitë e vogla atëherë kur e kishin të vështirë për të depërtuar tek opinioni publik.

Gratë tregojnë një shkallë të ulët të pjesëmarrjes në jetën politike, mirëpo situata dalëngadalë po përmirësohet si rezultat i angazhimit të organizatave të shoqërisë civile. Zhvillimi lokal, si vizion i ri i zhvillimit të shtetit, është sfida më e rëndësishme në tranzicionin e Malit të Zi. Më shumë kompetenca duhet t'u kalohen autoriteteve lokale, të cilat do të bëhen partnerët më të rëndësishëm në përpjekjet e bashkësive për t'u zhvilluar, për të krijuar jetë më të mirë dhe për të realizuar të drejtat e qytetarëve.





Infrastruktura dhe shërbimet komunale të dobëta nxisin pakënaqësi të vazhdueshme tek pjesa dërrmuese e popullatës. Si rrjedhim i kësaj, ajo që dikur ka qenë reagim i dobët i bashkësive të cilat marrin shërbime publike tejet të dobëta, tani vjen duke u rritur dhe qytetarët gjejnë mënyra për të shfaqur pakënaqësinë e vet dhe të kërkojnë kushte më të mira të jetesës.

Neni 109 i Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale, që u miratua në vitin 2003, parashikon që qeverisja lokale duhet të marrë mendimin e opinionit publik rreth çështjeve që i përkasin tërë komunës si dhe ta përfshijë atë në procesin e krijimit të politikave dhe të hartimit të buxhetit.

